

## A DO TË MBIJETOJË MINISTRI I SHËNDETËSISË MEGASKANDALIN E FUNDIT

**Nikola Todorov është bebjja e vdekur e Gruevskit**

Shëndetësinë në Maqedoni e dridh megaskandal pasi që doktorë të punësuar në Klinikën për gjinekologji ndanë me publikun se 80 bebe të porsalindura kanë vdekur për gjashtë muaj në spitalin. “Fokus” disponon me dokumente, emra dhe mbiemra të pacientëve që kanë lindur në klinikë, dhe i kanë humbur bebet, si dhe me emrat e gjinekologëve që i kryenin lindjet ose operacionet si seksioni cezarian. Vendosëm ta fshehim identitetin e doktorëve. Si arsye më të shpeshta për vdekjen e zmadhuar të bebeve të porsalinduratheksohen infeksionet, me të cilët nënat dhe bebet infektohen deri sa gjenden në spital. Nga Gjinekologjia, deklarojnë se numrat janë nxjerrë jashtë kontekstit. Drejtorja Haxhi-Lega ka shkuar në pushim, ndërsa brenda klinikës është zhvilluar hulumtim i brendshëm për atë se kush i ka nxjerrë dokumentet e pacientëve. Një pjesë e historive të mjekimit janë mbyllur me çelës që doktorët mos të kenë qasje deri në to. Ministri Todorov, në vend se të merr përgjegjësi, ai heshtë, ndërsa nga Ministria për shëndetësi na dërguan përgjigje në pyetjet tona me vokabular të shtabit partiak të DPMNE-së

**Shkruan: Irena MULAÇKA**

Më 31 maj të vitit 2011, vetëm pesë ditë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ish-kryeministri **Nikola Gruevski** e preu lentën e kuqe të ndërtesës të re të Klinikës për gjinekologji në Shkup, e cila u ndërtonte dhjetë vite të plota dhe në të cilën me hapjen e saj u trashëguan skandalet e vjetra. Vetëm gjatë disa muajve, tre herë u paralajmërua hapja solemne e ndërtesës.

Herën e parë shkonte edhe reklamë në mediat pro qeveritare, por ndërtesa nuk u hap, më vonë edhe mediat i ftuan, ndërsa mysafirët erdhën me dhurata dhe lule dhe prap u anulua hapja solemne, që në fund të hapet ndërtesa vetëm disa ditë para zgjedhjeve.

Qeveritarët bënë promovimin e objektit, i cili në atë kohë ende nuk i kishte dokumentet se është gati për përdorim, ndërtesa ishte gjysmë e zbrazët, pa mjete mjekësore të mjaftueshme, ashensorët nuk funksiononin, por, prap se prap, para hyrjes së klinikës foto sesion bënë kryeministri i atëhershëm, ish-ministri i shëndetësisë **Bujar Osmani**, drejtorë të klinikave dhe doktorë.

Prej atëherë, pushtetarët e shëndetësisë vazhdimisht lavdërohen me mjetet e reja mjekësore, të cilët janë sjellë në spitalin me anë të tenderit qeveritar, i cili kushtoi 100 milion euro, por as ajo nuk i zvogëloi skandalet që e dridhnin Gjinekologjinë.

Pesë vite pas lëshimit në përdorim, numri i fëmijëve të sapo lindura vazhdimisht rritet, por problemi është në atë se këto numra alarmante fshehën nga ana e institucioneve përkatëse dhe askush nuk merr përgjegjësi për jetët e humbura, për komplikimet gjatë lindjes, për arsyet e vdekjes, për dhimbjen e familjeve...

Nga ana tjetër, në tërë botën e civilizuar, problemet e tilla zgjidhen shpejt, ministrat e shëndetësisë marrin përgjegjësi morale dhe politike, ndërsa pacientët vendosin a do të ngrisin procedura gjyqësore për gabimet mjekësore dhe a do të kërkojnë dëmshpërblim.

Për dallim, në Maqedoni, institucionet përkatëse me vite të tëra i fshehin të dhënat zyrtare. Numrat e vetme që mund të gjinden janë ato të Entit shtetëror të statistikave, sipas të cilëve, në tremujorin e parë të vitit 2016 kanë vdekur 61 fëmijë të porsalindur, që paraqesin të dhëna pas të cilëve duhet të ndizet drita e kuqe e alarmit. Por, përveç të këtyre të dhënave, nga Klinika për gjinekologji në Shkup asnjëherë nuk kanë dalë me informata – sa fëmijë kanë vdekur në nivel vjetor, pse numri i fëmijëve të porsalindura që kanë vdekur po rritet dhe cilët janë arsyet më të shpeshta për atë? Numrat i ruajnë si sekret shtetëror ose si “informacion konfidencial”.

## **BEBET VDESIN SI NË AFRIKË**

Sipas informatave të fundit zyrtare në gjashtë muajt e fundit në Klinikën për gjinekologji kanë vdekur 80 fëmijë të porsalindura, prej të cilëve 20 kanë vdekur në dy javët e fundit. Këto të dhëna janë treguar në Kolegjiumin profesional të klinikës para disa ditëve në të cilin rregullisht marrin pjesë afër 70 doktorë, të cilët janë habitur nga numri i madh. Ato në bazë ditore dërgojnë raport, në të cilin së pari referojnë gjinekologët – për atë se çfarë ka ndodhur gjatë detyrës gjatë mbrëmjes së kaluar, më pas pediatret nga kujdesa intensive tregojnë sa fëmijë janë venduar në respirator, a i është keqësuar gjendja ndonjë foshnjës, a ka të vdekur dhe sa janë larguar nga spitali. Gjithashtu, në Kolegjiumin profesional dy herë në javë lexohet edhe programi për operacione.

Afër një vjet, atmosfera në Klinikën për gjinekologji në Shkup është duke vluar, ndërsa problemet dolën në sipërfaqe muajin e fundit kur një pjesë e të punësuarve aty vendosën të ndajnë me publikun çka është duke ndodhur në klinikën, sa fëmijë të porsalindur kanë vdekur dhe cilët janë arsyet për atë.

“Fokus” disponon me dokumente, emra dhe mbiemra të pacientëve që kanë lindur në klinikën, dhe i kanë humbur fëmijët, si dhe me emrat e gjinekologëve që i kanë bërë lindjet ose operacionet për lindje me seksion cezarian. Klinika për gjinekologji është qendër rajonale në të cilën vijnë të gjithë rastet kritike për të lindur, nga spitalet nga brendësia e shtetit, si dhe nga spitalet private. Redaksioni jonë vendosi të zbulojë identitetin e doktorëve që i kanë bërë lindjet ose operacionet. Sipas dokumenteve me të cilët disponojmë, rasti i fundit i fëmijës së vdekur ka qenë të premtën e kaluar, më 24 qershor, kur fryti i vdekur i nënës pas orës 14 ka qenë i nxjerrë me seksion cezarian. Foshnja ka qenë vajzë, me peshë 3,830 gram dhe e gjatë 52 centimetra. Sipas numrit të historisë të pacientes 7659, bëhet fjalë për **M.J.** gruaja 35 vjeçare e cila ka qenë e hospitalizuar më 1 qershor këtë vit. Gjatë kësaj periudhe asaj dy herë i është lejuar të shkojë në shtëpi, gjatë fundjavave. Pacientja ka edhe një fëmijë shtatë vjeçare.

Burimet tona komentojnë se pas operacionit ajo ka qenë në shok-dhomë, ndërsa më vonë është transferuar në Departamentin për shtatzëni patologjike. Në ndërkohë, pacientja në klinikë ka qenë afër 20 ditë sepse sipas doktorëve ka pasur më shumë ujë të frytit dhe ka pritur që t'i bëjnë operacion me seksion cezarian. Kur e kanë venduar në programin për operacione, kanë zbuluar se pacientja ka fëmijë të vdekur. Seksionin cezarian e ka bërë një gjinekolog, të cilit i kanë ndihmuar dy asistentë, ndërsa indikacionet i ka parashtruar doktor tjetër. Ende nuk janë zbuluar arsyet e vërteta – pse ka vdekur fëmija, a bëhet fjalë për gabim të doktorëve dhe kush do të merr përgjegjësi për jetën e humbur. Priten edhe rezultatet e autopsisë nga Instituti për patologji. Dy javë

më herët, edhe një fëmijë e porsalindur ka vdekur në Klinikën e gjinekologjisë. Sipas dokumenteve, bëhet fjalë për pacienten 25 vjeçare **I.B.** e lindur në vitin 1991. Ajo më 10 qershor ka lindur në klinikën, dhe ka lindur bebe të gjallë, djalë, me peshë 2,800 gram, ndërsa 50 centimetra i gjatë. Siç shkruan në historinë, pacientes i është bërë seksion cezarian në ora 21 dhe 55 minuta me diagnozë “min.apgar-skor 4/4 nizok” ndërsa tre ditë më vonë, më 13 qershor, bebja ka vdekur. Atë ditë kanë vdekur edhe dy fëmijë të porsalindura, që sipas doktorëve është situatë alarmante për të cilën duhet të reagohet në kohë që të merren masa përkatëse dhe mos të vazhdojë trendi i njëjtë i vdekjeve. Pasi që tema doli në opinion, u paraqitën disa paciente të cilët dëshironin të tregojnë se çfarë kanë kaluar në labirintet mjekësore në Klinikën e gjinekologjisë. Njëra prej tyre në rrjetet sociale shkroi se kur ajo në muajin e pestë të shtatzënisë e ka humbur fëmijën, në periudhën e njëjtë në klinikën kanë vdekur tre bebe të tjera. Për ndryshe, në Klinikën e gjinekologjisë në Shkup, gjatë vitit ka mes 5,000 dhe 5,500 lindje, ndërsa në gjashtë muajt e parë të vitit 2016 në këtë klinikë ka pasur afër 2,700 lindje.

## **FSHEHEN HISTORITË E PACIENTEVE QË KANË LINDUR**

Sa më shumë zhvillohet kjo storje, aq më shumë dalin në sipërfaqe fatet tragjike të nënave dhe foshnjave të tyre. Në dokumentet me të cilët disponon “Fokus” ka të dhëna në të cilët ka informata për pacientet që kanë humbur foshnjat, qytetin prej nga kanë ardhur, gjinia e fëmijës, sa ka peshuar dhe sa ka qenë e gjatë si dhe cila është diagnoza.

Prej tyre kuptuam për një rast të vdekjes të një fëmijës të porsalindur në shkurt, këtë vit. Operacioni ka qenë i kryer me seksion cezarian në periudhën nga ora tetë deri në ora nëntë në mëngjes në fund të detyrës. Pacientja ka lindur vajzë, me peshë 2,300 gram dhe 45 centimetra e gjatë. Është e çuditshme se në dokumentin me të cilin disponojmë, askund nuk mund të gjejmë numrine historisë së pacientes, edhe pse të gjithë pacientet e hospitalizuar kanë numër të historisë. Në dokumentin janë të shënuar vetëm të dhënat bazike – emri dhe mbiemri, gjinia e fëmijës, vendi prej nga vjen dhe pesha e fëmijës.

Sipas burimeve nga spitali, bebja ka lindur e gjallë, por nuk dihet sa kohë ka qenë e gjallë dhe cilët janë arsyet e sakta për vdekjen. Redaksioni jonë e di emrin e gjinekologut që e ka bërë seksionin cezarian, por vendosëm mos ta zbulojmë identitetin e tij.

Gjinekologët me të cilët biseduam në këtë temë thonë se arsyet më të shpeshta për vdekjen e zmadhuar të fëmijëve të porsalindur janë infeksionet intrahospitale me të cilët nënat dhe bebet infektohen deri sa gjinden në spital. Por, theksojnë se ka gabime të caktuara edhe te doktorët sepse disa prej tyre nuk e bëjnë punën e tyre ashtu si duhet, ose në mënyrë joprofesionale i trajtojnë pacientet. Gjithashtu, një nga arsyet për të dhënat alarmante është edhe lindja e parakohshme.

- *Qysh nga viti 2005 nuk mbahet evidencë e rregulltë në të gjitha vendet për lindje për atë se sa fëmijë të porsalindur kanë vdekur, ku ka probleme dhe në çfarë mënyre zgjidhen. Nuk mund vetëm në fund të vitit të shihen numrat dhe këtu gjithçka të mbarojë. Duhet rregullisht, gjatë tërë vitit të ndiqet situata dhe të detektohen dobësitë të*

*cilët janë shumë në numër. Këto numra nuk janë detyrë e entit për statistikë, por të Institutit për shëndet publik ose të Klinikës të gjinekologjisë. Ato duhet t'i zgjidhin dobësitë. Probleme tjera janë higjiena në klinikën, sepsa, ndryshimi i personelit, tani ka motra mjekësore të reja pa përvojë pune, lëshimet që i bëjnë shërbimet dhe fëmijët e lindura para kohe – theksojnë gjinekologët të cilët dëshiruan të mbesin anonim duke pasur frikë mos të kanë pasoja.*

Sipas procedurës, pasi që bebet vdesin, i dërgojnë në obduksion në Institutin për patologji, ku drejtoresha është d-r Gordana Petrushevska. Për gjetjet nga autopsia zakonisht pritet një ose dy muaj, ndërsa ato duhet të japin përgjigjen finale dhe të tregojnë arsyet e vërteta që e kanë shkaktuar vdekjen të fëmijës të porsalindur.

“Fokus” deri më tani publikoi disa raste të bebeve të vdekura në disa vitet e fundit. Ashtu, një paciente, e cila ishte në javën e 35 të shtatzënisë ka humbur një nga binjakët shkaku i hernies (killëve). Fati të keq kishte edhe një paciente tjetër me binjakë, një prej të cilëve vdiq për shkak të mushkërive të plasaritura. Në situatë të ngjashme, u gjet edhe një nënë tjetër - ajo humbi fëmijën e saj, që peshonte 3,900 gramë për shkak të ventilimit të tepërt që shkaktoi shpërthimin e mushkërive. Të njëjtin vit, foshnja e një gruaje 29 vjeçare pas lindjes ishte infektuar me klepsiel dhe mezi u shpëtua. Gjithashtu, në tetor, vitin e kaluar, në spitalin e Gjevgjelisë, vdiqën një grua dhe fëmija e porsalindur, shtatzënia e të cilës ka qenë në rregull deri në momentin e lindjes. Në atë rast, problemi ishte një gabim mjekësor i dy anestezistëve të cilët u pezulluan nga puna. Se është rritur numri i bebeve të vdekura në pesë vitet e fundit, në të gjitha spitalet në vend tregojnë edhe nga Platforma për barazi gjinore, të cilët kanë bërë hulumtime në këtë temë. Sipas tyre, është e neveritshme se në periudhën e zbatimit të Strategjisë për nënat e sigurt (2010-2015) dhe në periudhën kur u reduktua buxheti për kujdesin preventiv, vdekshmëria e foshnjave është në rritje. Kështu, në vitin 2011, tetë foshnja kanë vdekur në 1000 lindje, dhe tre vjet më vonë, në vitin 2014, ky numër u rrit në nëntë vdekje në 1,000 lindje. Ata nuk kanë bërë hulumtime për dy vitet e fundit, por më alarmuese janë të dhënat nga viti 2012.

*- Rritja më dramatike e vdekshmërisë së foshnjave të porsalindura në pesë vitet e fundit ka ndodhur në vitin 2012, kur vetëm për një vit, numri i foshnjave të vdekura është zmadhuar në 25 në 1000 lindje – thuhet në hulumtimin e tyre.*

Si problem shtesë i Klinikës për gjinekologji theksohet edhe mungesa e doktorëve, gjinekologëve, anesteziologëve dhe pediatre. Burimet tona pohojnë se në Gjinekologji ka vetëm nëntë pediatre, ndërsa duhet të jenë 15, ka 10 anesteziolog ndërsa duhet të ketë minimum 18. Vetëm vitin e kaluar nga klinika janë larguar katër anesteziolog që të punojnë në spitalet private.

Pasi që doli afëra për vdekjen e zmadhuar të foshnjave të porsalindura në Gjinekologji, burimet tona treguan se në klinikë është bërë hetim i brendshëm për atë se kush i ka nxjerrë dokumentet e pacienteve, ndërsa një pjesë e historive mjekësore janë mbyllur me çelës, që doktorët mos të kenë qasje deri në to.

## DREJTORESHA E GJINEKOLOGJISË HESHTË NË LIDHJE ME RASTIN ME BEBET

Rritja e vdekshmërisë së foshnjave shkaktoi reagime të ashpra në publik dhe qytetarët u tronditën nga shifrat që për gjashtë muaj kanë vdekur 80 fëmijë të porsalindura.

“Fokus” i dërgoi pyetje drejtoreshës së Klinikës për gjinekologji në Shkup, d-r Marija Haxhi-Lega, e cila sipas informatave tona, ka shkuar në pushim. Në porosinë që ja dërguam drejtoreshës, më 25 qershor, e pyetëm a janë të sakta informatat se në klinikën kanë vdekur 80 foshnje për gjashtë muaj, prej të cilëve 20 kanë vdekur në dy javët e fundit dhe cilët janë arsyet më të shpeshta për vdekjen e zmadhuar të bebeve. Deri në publikimin e tekstit nuk morëm përgjigje në pyetjet tona.

Por, nga Klinika e gjinekologjisë dolën në konferencë të shtypit duke deklaruar se numrat e publikuara janë nxjerrë prej kontekstit, por assesi nuk donin t'i tregojnë numrat e saktë të bebeve të vdekura nga janari e deri më tani. Ato treguan se të dhënat statistikore bëhen në fund të vitit ose një herë në pesë vjet që të shihet trendi.

- *Trendi bëhet në bazë të analizave dhe të dhënave të mbledhura për një vit, pesë vjet ose më shumë vjet, e jo në bazë e të dhënave për shtatë ditë* – theksoi d-r **Dragan Tanturovski** nga GAK.

Redaksioni i “Fokus” nuk ishte i ftuar në konferencën e shtypit të Klinikës për gjinekologji, edhe pse ne të parët e publikuam aferën, por pasi që disa nga gazetarët i thanë doktorit Tanturovski, se nëse nuk tregon numra, atëherë ai krijon dyshime se janë duke fshehur diçka, ndërsa ai u zemërua dhe filloi të bërtasë:

- *Unë punoj si doktor afër 33 vjet, nuk lejoj sjellje të tillë, profesionalizmi im është gjithmonë në vend të parë. Askush nga rangu i juaj nuk mund të më poshtërojë!*

Por, burimet tona na informuan se sipas rregullave të klinikës në çdo gjashtë muaj përgatitet raport për atë sa fëmijë janë lindur dhe sa kanë vdekur në këtë periudhë.

Disa pyetje i dërguam edhe ministrit të shëndetësisë Nikola Todorov. Këto ishin pyetjet:

1. Çfarë planifikoni të ndërmerri në lidhje me numrat alarmuese të vdekjeve në Klinikën për gjinekologji në Shkup?
2. A disponon Ministria me numra zyrtare?
3. A do të jepni dorëheqje pas këtyre ngjarjeve?

Por, deri në mbylljen e këtij numri nuk morëm përgjigje nga njeriu i parë i shëndetësisë, i cili në disa ditët e fundit është i angazhuar me negociatat për zgjidhje të krizës politike si përfaqësues i VMRO-DPMNE-së. Se kanë vdekur 82 bebe në Gjinekologji në gjashtë muajt e fundit, prej të cilëve 20 në fy javët e fundit, reagueshan edhe nga partia e parë e opozitës LSDM. Ato i bënë thirrje ministrit të mbajë përgjegjësi morale për shifrat e tmerrshme që e tronditën spitalin. Menjëherë reagueshan edhe nga DPMNE, dhe theksuan se gjatë qeverisjes së tyre numri i fëmijëve të vdekura është më i vogël në krahasim me kohën e LSDM-së.

## KËSHILLTARI I ISH-KRYEMINISTRIT UDHËHEQ KOMITETIN PËR MËMËSI TË SIGURTË

Pasi që në vitin 2010, për vetëm disa javë vdiqën disa nëna dhe fëmijë të porsalindura në Ministrinë për shëndetësi u formua Komiteti për mëmësi të sigurt, qëllimi i të cilit ishte të përmirësohen kushtet sanitare dhe higjienike në spitalet, të sigurohen kushte

normale për lindje, të blihet pajisja e nevojshme mjekësore, të sigurohet personel të mjaftueshëm, ndërsa nga ana tjetër, të zvogëlohet numri i vdekjeve të fëmijëve të porsalindura.

Në krye të Komitetit është **Aleksandar Mitov**, këshilltar për shëndetësi në kabinetin e ish-kryeministrit Gruevski. Përveç tij, ky komitet ka 15 anëtarë mes të cilëve është drejtoresha e Klinikës së gjinekologjisë, Haxhi-Lega, drejtoresha e Klinikës për sëmundje të fëmijëve, **Aspazija Sofijanova**, dy përfaqësues nga Ministria përkatëse, si dhe këshilltarë nga kabineti i ministrit Todorov. Në disa vitet e fundit janë ndërruar disa doktorë – anëtarë të komitetit. Shkojnë të vjetërit - vijnë të ri.

Komiteti u formua në periudhën kur brenda disa ditëve vdiqën katër nëna dhe tre bebe. Prej atëherë e deri më sot, nuk kemi asnjë informatë nga ky institucion, dhe komiteti nuk ka mbajtur asnjë konferencë të shtypit për të shpjeguar çfarë masa ndërmerren dhe a funksionojnë në këtë rast.

Sipas informatave tona, pesë muajt e fundit ky komitet nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, ndërsa nga themelimi i tij në vitin 2010, janë mbajtur vetëm tre takime. Por kuptuam se as ata nuk kanë pasur numrat e saktë të fëmijëve të vdekur në Klinikën për gjinekologji! Është fakt se, çdo vit, në vend se të zvogëlohet, numri i vdekjeve të fëmijëve të porsalindura zmadhohet, dhe shkaku i kësaj Maqedonia është shpallur si kampion i zi për vdekjen e bebeve në Evropë, për atë tregojnë edhe të dhënat e fundit nga indeksi evropian për përdoruesit e shërbimeve mjekësore, i cili doli vitin e kaluar. Aty Maqedonia është e ranguar në vendin e 27 nga 35 shtete gjithsej, të cilët kanë qenë të përfshirë në studimin.

Në raportin që vjen nga Brukseli, theksohet se shteti jonë duhet të kalojë rrugë të gjatë për të përmirësuar sigurinë shëndetësore. Sipas informatave, në nivel vjetor në Maqedoni në 1000 lindje vdesin 11 bebe. Menjëherë pas Maqedonisë janë Shqipëria dhe Serbia, ndërsa situata është më e mirë në Islandë, Finlandë dhe në Slloveni ku në 1000 lindje regjistrohen 2 vdekje.

Në vend se drejtoresha dhe doktorët e Gjinekologjisë të fjalosen me gazetarët, ato kanë mundësi të dalin dhe t'i tregojnë numrat e saktë të bebeve të vdekura në gjashtë muajt e parë të vitit. Ato i kanë raportet dhe i dinë numrat. Besojmë se janë të vetëdijshëm se funksioni nuk është më i rëndësishëm se jetët e humbura.

Suazë:

## **Në vend se të jep përgjigje në pyetjet tona MINISTRIA NDANË OFENDIME SI SHTAB PARTIAK**

Më shumë se dy vjet, Ministria e shëndetësisë nuk u përgjigj në asnjë pyetje të “Fokus”, por më në fund ndjen përgjegjësi të përgjigjen për skandalin në Klinikën për gjinekologji. Edhe pse parashtruam pyetje konkrete dhe kërkuam të dhëna precize për këtë temë, nga ministria na u përgjigjën me sulme të pabaza, diskualifikime dhe etiketime. Që të vërtetoheni, ju prezantojmë pyetjet integrale dhe përgjigjet e tyre:

**FOKUS:** Çfarë do të ndërmerrni për vdekjet e zmadhuara të fëmijëve të porsalindura në Klinikën për gjinekologji në Shkup, ku në gjashtë muajt e fundit kanë vdekur rreth 80 bebe, prej të cilëve 20 kanë vdekur në dy javët e fundit?

**FOKUS:** A do të reagon ministri i shëndetësisë Nikola Todorov?

**FOKUS:** A planifikon Todorov të merr përgjegjësi morale për ngjarjet në Klinikën për gjinekologji, duke marr parasysh atë se vazhdimisht ka dalë me deklarata se numri i vdekjeve të bebeve vazhdimisht zvogëlohet?

**FOKUS:** A disponon ministria me numrat zyrtare?

**MINISTRIA PËR SHËNDETËSI:** Në Klinikën universitare për gjinekologji në aspekt të pajisjes dhe kushtet infrastrukturore janë të përmbushura të gjitha standardet. Me pohimin tuaj ju thoni se problemi në Klinikën është stafi dhe paaftësia e tyre. Ministria për shëndetësi nuk mund të pajtohet me këtë konstatim të gabuar, i cili ka prapavijë politike, dhe si Ministri besojmë se në Klinikë punojnë profesionistë të arsimuar të cilët janë të gatshëm të ballafaqohen me rastet më të komplikua në këtë fushë, ose të luftojnë për shëndetin e pacientëve me sëmundje më të rënda. Qytetarët duhet të dinë se kjo nuk është asgjë tjetër përveç se një fushatë e porositur të cilën ju e punoni me kërkesë të LSDM-së.

Populli e di se çfarë la pa vete LSDM, sa ishte numri i vdekjeve në kohën e tyre, por di edhe atë se tani kemi pajisje të re, edukime dhe spital krejtësisht të ri i cili punon në pajtim me të gjitha protokollet botërore dhe në këtë fushë kemi bërë hapa të mëdha. Tregues për atë është numri i zvogëluar i vdekjeve të fëmijëve të porsalindur – këto janë fakte, këtë që e bëni ju nuk është asgjë tjetër përveç se është propagandë e pistë politike. Ju vazhdoni të gënjeni dhe të punoni në porosi të paguara politike, ndërsa ne do të vazhdojmë të investojmë në pajisje të re, trajnime dhe infrastrukturë të re shëndetësore.

## SKANDALI NË KLINIKËN PËR GJINEKOLOGJI NË SHKUP PO PËRHAPET

Vdiq edhe një bebe, pushteti shëndetësor heshtë

Vetëm disa ditë pasi që shpërtheu afëra në Klinikën për gjinekologji në Shkup, se afër 80 foshnje kanë vdekur në gjashtë muajt e parë të vitit, prej të cilëve 20 brenda dy javëve, një vdekje e re e një fëmijës të porsalindur përsëri tronditi spitalin. Sipas dokumenteve dhe numrit të historisë të pacientes 8261, bëhet fjalë për nënën K.S. nga fshati Batinci, Shkup, e cili u dërgua në klinikë si një rast emergjent dhe kishte lindje të parakohshme. "Fokus" bisedoi me disa nga familjet që kanë përjetuar një tragjedi të tillë. Ata presin të kalojë një periudhë e caktuar për tu zvogëluar dhimbja, për të ndarë me publikun çfarë gollote kanë kaluar në klinikë, si i kanë trajtuar mjekët dhe infermieret aty dhe në çfarë kushte kanë qëndruar. Madje disa prej tyre janë duke shqyrtuar mundësinë për të paditur gjinekologët që kanë bërë lindjen si dhe klinikën. Kemi informata se ka pasur disa ankesa nga nënat që kanë lindur deri te Ministria e Shëndetësisë

**Shkruan: Irena Mulaçka**

Ministri për shëndetësi në Malin e Zi, **Miodrag Radunović** para dy viteve dha dorëheqje nga funksioni, pasi që një fëmijë e porsalindur vdiq në spitalin në Bjelo Pole për shkak të infektiveve. Ai publikisht doli në televizion dhe para tërë opinionit tha se e braktisë pozitën për shkak të vdekjes së fëmijës, skandalit që shpërtheu dhe mosfunksionimit të sistemit shëndetësor.

Sipas mediave, Komisioni për shëndetësi në Kuvendin e Malit të Zi dhe deputetët janë pajtuar që ministri Radunović dhe drejtori i spitalit **Tomislav Jeremić** ku ka ndodhur kjo ngjarje të dëgjohen dhe të japin shpjegime në çfarë kushte linden dhe trajtohen bebet dhe pse është lejuar kushtet higjienike të jenë arsyeja kryesore për infektimin e pesë fëmijëve të porsalindur. Në ndërkohë, janë ndërruar krerët e departamenteve për gjinekologji dhe neonatologji, ndërsa drejtori ka dhënë dorëheqje për arsye morale.

Për dallim nga Mali i Zi, situatë të njëjtë nuk pamë në Maqedoni edhe pas publikimit i të dhënave skandaloze se vetëm për gjashtë muaj në Klinikën për gjinekologji në Shkup kanë vdekur rreth 80 bebe, prej të cilëve 20 në dy javët e fundit. As ministri për shëndetësi **Nikola Todorov**, e as drejtoresha e Gjinekologjisë, **Marija Haxhi-Lega** nuk ndjen përgjegjësi t'i shpjegojnë ngjarjet që ndodhën në klinikën – pse aq numër të madh të bebeve kanë vdekur për gjashtë muaj, nuk deklaruan asgjë për këtë, dhe nuk dhanë dorëheqje nga funksionet e tyre për arsye morale. Todorov merret me negociata për zgjidhje të krizës politike në vend, ndërsa drejtoresha këto ditë është kthyer nga pushimi vjetor.

Në tërë aferën, nuk bëhet fjalë vetëm për gabime të doktorëve ose për zbatim joprofesional të operacioneve dhe të infektiveve intrahospitale të nënave, por, siç thonë doktorët, bëhet fjalë për gabim sistematik, i cili me vite të tëra e rrënon sistemin shëndetësor në të cilin më së shumti vuajnë pacientët, ose në këtë rast bebet.

Sipas tyre, pa organizimi dhe mungesa e gjinekologëve, pediatreve dhe anesteziologëve në spitalet në qytetet tjera të vendit kontribuojnë që të gjithë rastet kritike të fëmijëve të porsalindur të vijnë në Klinikën për gjinekologji, ndërsa faji më i



madh i shkruhet ministrit Todorov, i cili çdo ditë në konferenca të shtypit lavdërohet për shëndetësinë e "reformuar", e cila është në komë të thellë. Në këtë mënyrë, kush mbijeton – do të tregojë!

## **RAST I RI I VDEKJES**

Nuk kaloi as një javë prej kur shpërtheu afera se në Klinikën për gjinekologji për gjashtë muaj kanë vdekur 80 bebe, dhe 20 vetëm në dy javët e fundit, në ndërkohë në klinikën vdiq edhe një bebe e porsalindur, me çka numri i rasteve është duke u zmadhuar. Për atë është folur në Kolegjiunin profesional të klinikës, ku raportohet për atë se çfarë ka ndodhur në spitalin gjatë fundjavës dhe gjatë detyrave.

Sipas burimeve tona, rasti i ri i vdekjes të fëmijës ka ndodhur të dielën në mëngjes, edhe pse nëna e ka lindur disa ditë më parë. Sipas numrit të historisë të pacientes – 8261, bëhet fjalë për nënën 34 vjeçare me initiale **H.S.** nga fshati Batinci, në Shkup, e lindur më 1982, e cila urgjentisht është sjellë në klinikën. Sipas burimeve tona, pacientja ka ardhur me përkeqësim të shëndetit sepse ka pasur gjakderdhje. Kjo do të thotë se kanë ndodhur komplikime të caktuara dhe fryti nuk ka pasur qarkullim dhe është humbur kontakti mes nënës dhe bebes.

Operacioni është bërë me seksion cezarian në javën e 36 të shtatzënisë, më 29 qershor, në periudhën nga ora 12.30 deri më 13.15, dhe vetëm disa ditë më vonë fëmija ka vdekur. Bebja ka pasur 3,090 gram, ka qenë e gjatë 53 centimetra. Është e rëndësishme të theksohet se këtu nuk bëhet fjalë për gabim mjekësor, sepse nëna nuk ka qenë e hospitalizuar në klinikën, por ka qenë urgjentisht e transferuar në operacion. Redaksioni jonë e di identitetin e gjinekologut që e ka bërë operacionin, si dhe emrin e gjinekologut që i ka parashtruar indiciet, por kemi vendosur mos t'i shpallim emrat e tyre.

Sipas dokumenteve me të cilët disponojmë, për shumicën e rasteve ku kanë vdekur fëmijë të porsalindur, operacionet janë bërë me seksion cezarian. Një prej tyre është edhe pacientja 39 vjeçare nga Shkupi, e cila, më 14 shkurt, të vitit 2016 ka lindur në Klinikën e gjinekologjisë. Ajo ka lindur vajzë, që ka peshuar 2,300 gram, ndërsa ka qenë e gjatë 45 centimetra, e cila pas disa ditësh ka vdekur. Në atë periudhë, në klinikën ka pasur edhe disa fëmijë të tjerë të cilët për kohë të shkurtër kanë vdekur, dhe familjet e tyre kanë reaguar, duke mos mundur të besojnë se çfarë kanë kaluar në labirintet e shëndetësisë në vend.

"Fokus" bisedoi me disa nga familjet që kanë përjetuar një tragjedi të tillë. Ata presin të kalojnë një periudhë e caktuar për tu zvogëluar dhimbja, për të ndarë me publikun çfarë gollgote kanë kaluar në klinikë, si i kanë trajtuar mjekët dhe infermieret në klinikë dhe në çfarë kushte kanë qëndruar. Madje disa prej tyre janë duke shqyrtuar mundësinë për të paditur gjinekologët që kanë bërë lindjen si dhe klinikën. Kemi informata se ka pasur disa ankesa nga nënat që kanë lindur deri te Ministria e Shëndetësisë.

Në numrin e kaluar, me publikun ndamë disa raste të nënave, të cilët në gjashtë muajt e fundit i kanë humbur bebet e tyre në Klinikën për gjinekologji. Një prej tyre ishte **I.B.**, e lindur më vitin 1991, e cila më 10 qershor ka lindur me seksion cezarian në klinikën dhe ka lindur djalë, ndërsa disa ditë më vonë, më 13 qershor, fëmija ka vdekur. Rast tjetër i foshnjës së vdekur kishte më 24 qershor, kur fryti i vdekur i nënës 35 vjeçare **M.J.** nga Shkupi u nxor me seksion cezarian.

Problem tjetër i klinikës, sipas doktorëve, është se në ndërtesën e re e cila funksionon vetëm pesë vjet deri më tani, me javë të tëra nuk ka pasur klima dhe ventilim, prandaj ato disa ditë vdekja e fëmijëve ka qenë ngushtë e lidhur me atë problem, më pas me javë të tëra, të punësuarit nuk kanë pasur letër higjienike, ndërsa higjiena në klinikën ka qenë në nivel të ulët, që sipas tyre është një nga arsyet për paraqitjen e infektiveve intrahospitale. Në ndërkohë, janë keqësuar marrëdhëniet ndërnjerëzore mes doktorëve dhe pjesa tjetër e stafit medicinal. Një pjesë prej tyre e përkrahin anën e drejtoreshës, ndërsa tjerët fajësojnë për mobing, presione, kërcënime dhe dëbime nga zyrat ku kanë punuar me vite.

## **BAKTERIET DHE INFEKTIMET PO MBYSIN NË GJINEKOLOGJI**

Si arsye më të shpeshta për shkallën e zmadhuar të vdekjes të fëmijëve të porsalindur janë lindjet e hershme, infektimet intrahospitale dhe paaftësia e disa doktorëve. Deri më tani, në Klinikën për Gjinekologji ka pasur edhe disa raste kur gjinekologët e ri kanë bërë vlerësime të gabuara – kur duhet të lindë gruaja, sa ujë të frytit ka në bark, kur e ka terminin, a është duke u zhvilluar mirë fryti, a mos ka anomali?

Klinika për gjinekologji në Shkup kohë të gjatë është duke u tronditur nga skandalet, ndërsa në sallat e operacionit është fundosur fati i shumë familjeve. Do të tregojmë vetëm disa raste të grave që kanë lindur, që kanë kaluar tmerrin e klinikës, edhe atë në ndërtesën e re. Një prej tyre është **Emilija Nikolova**, 36 vjeçare, nga Strumica, e cila thotë se ka kaluar rrugë të vrazhdë në Klinikën për gjinekologji, prandaj vendosi ta tregojë përvojën e saj.

*- Nuk jam e befasuar se vdesin aq numër i madh i fëmijëve sepse secili pacient që vjen nga qytetet tjerë, që ka komplikime me shtatzëninë, edhe nëse nuk është kohë për të lindur, ato menjëherë e bëjnë operacion që të lindë. Cila fëmijë ka fat, do të mbijetojë. Unë me anë të ndihmës të shpejtë u transferova në Shkup duke pasur gjakderdhje në javën e 31 të shtatzënisë. Së pari isha e vendosur në Patologji, ndërsa më vonë shkaku i mungesës të vendit, ditën e tretë më transferuan në kujdes intensive me arsyetim se do të jem në duar të sigurt. Aty çdo ditë ndodhnin gjëra të tmerrshme, çdo ditë vdisnin gratë që lindin. Nga stresi i madh kisha gjakderdhje. Sapo i qetësua gjakderdhja më bënë CTG dhe më si duket ka treguar se kam probleme. Problemi kryesor ishte se nuk kishin ku t'i vendosin gratë, prandaj çdo natë bënin një lindje të parakohshme dhe bebet vdisnin – tha Nikolova për "Fokus".*

Ajo shtoi se në këtë mënyrë ka filluar tmerrin e saj në klinikën, i cili i ka lënë trauma të mëdha.

*- Nga stresi i madh pesë ditë nuk isha në tualet. Më morën që të më lindin me seksion cezarian dhe linda djalë të cilin shkaku i komplikimeve menjëherë e venduan në inkubator. Kur pyeta ku është dhe si është fëmija ime, drejtorja filloi të më bërtet dhe të më thotë se duhet të jem e lumtur që fëmija është gjallë dhe mos të pyes shumë dhe të lutem që të mbijetojë sepse mund t'i ndodh edhe gjëja më e keqe. Kaluam proces të gjatë dhe të vështirë, por unë e di se më nuk do të lindi aty. Unë jam dëshmitare dhe e di pse fëmijët vdesin në Gjinekologji – shtoi Nikolova.*

Sipas saj, duke mos pasur ku t'i vendosin gratë që lindin shumë prej tyre kanë qenë të vendosur në korridor, dhe aty ka pasur shumë insekte, ndërsa tualetet kanë qenë të papastër si në filmathorror.

Ka përjetuar gjë të tmerrshme dhe jetën e ka pasur në rrezik edhe pacientja 24 vjeçare, e cila para më shumë se një viti ka lindur në klinikë dhe i ka lindur fëmijë e shëndoshë. Burimet tona mjekësore thonë se në periudhë prej disa ditëve deri sa nëna ka qëndruar në klinikën është infektuar me bakter, gjendja shëndetësore iu është keqësuar, ia kanë nxjerrë mitrën. Stafi i "Fokusit" u takua me nënën që dëshiroi të jetë anonime, por na tregoi çfarë ka përjetuar gjatë qëndrimit të saj në klinikë.

*- Për atë vend kam vetëm një fjalë – horror. Kur shkon, shikon ndërtesë të re dhe në fillim gjithçka duket se është në rregull. Aty ka higjienë të tmerrshme, prandaj nuk është për t'u habitur kur gratë dhe fëmijët infektohen me bakterinstreptokokë dhe klepsella. Insekte ecin në të gjitha anët, çarshafët janë të përlyer dhe pastaj habitemi me infektimet intrahospitale. Sjellja e motrave medicinale dhe të infermierëve është e keqe dhe arrogante. Unë shkaku i bakterit, mbeta pa mitrën, mezi më shpëtuan dhe tani nuk mund të kem edhe një fëmijë. Dhe pastaj nuk dimë pse gratë mbledhin para për të lindur në spitalet private – tha gruaja 26 vjeçare.*

"Fokus" disa vite më parë raportoi për një rast ku një fëmijës që kishte vetëm dy muaj, nga brendia e shtetit, shkaku i infeksionit, morri gangrenë dhe ia amputuan dorën. Prindërit e saj, dërguan ankesë deri te ministri për shëndetësi Todorov, por prej atëherë e deri më tani, ky rast nuk u zgjodh. Sipas dokumenteve, bëhet fjalë për vajzë, për të cilën prindërit në ankesën që ia dërguan ministrit thonë se bakteretstafilokokë dhe streptokokë, por edhe moskujdesja e doktorëve dhe shërimi joprofesional janë arsyet për fatin e keq të bebes.

*-Fëmija jonë u lindë më 14 tetor, të vitit 2011 si fëmijë e lindur parakohe, dhe për atë e mbajtën në mjekim në klinikën. Ne dhjetë vite nuk kemi pasur fëmijë, dhe pas gëzimit të madh u ballafaquam me një goditje të fortë. Në dorën e foshnjës kishte fryrje të bardha, ndërsa askush nuk dëshironte të na shpjegojë se për çfarë po bëhet fjalë. Informatën e vetme që na dhanë ishte se dora e vajzës tonë duhet të amputohet, ndërsa pse dhe qysh, askush nuk na shpjegoi – shkruan në ankesën e dërguar deri te ministri.*

Pas ankesës së ardhshme që e kanë dërguar, prindërit më 11 nëntor të vitit 2011 kanë arritur të marrin dokumentacionin e fëmijës, në të cilin sipas tyre ka shumë gjëra të palogjikshme. Sipas dokumentit nga gjinekologjia, te fëmija është izoluar bakteristreptokokë, i cila ka shkaktuar sepsë të hershme.

Por, kjo nuk është e tëra. Sipas dokumenteve me të cilët disponojmë, para fillimit të vitit 2012, tre fëmijë kanë vdekur gjatë një detyrës. Edhe atë, dy nga bebet kanë vdekur shkaku se nuk kanë qenë mjaft të zhvilluara, kanë lindur në javën e 26, ndërsa e treta ka lindur në javën e 31, ka pasur mundësi të mbijetojë, po mos të ishte e infektuar nga bakteriklepsiela. Problem tjetër në lidhje me këtë është se edhe pas rasteve të shumta të vdekjeve dhe infektimit e ndryshme, nuk është ndezur alarmi tek pushteti, që të gjendet mënyrë për të parandaluar ose për të zvogëluar numrat e mëdha të këtyre rasteve.

Dhe pas dhjetë ditëve, drejtoresha e Gjinekologjisë, **Marija Haxhi-Lega** heshtë për skandalin. Siç kuptuam, pas shpërthimit të aferës, ajo për herë të parë është paraqitur në punë të mërkurën pas kthimit nga pushimi vjetor.

Burimet tona thonë se drejtoresha në Kolegjiunin profesional është grindur me të punësuarit duke thënë se ajo e di se kush i nxjerrë dokumentet nga klinika dhe për atë do të dënohet.

## SPITALE TË MBYLLURA, MUNGESË TË GJINEKOLOGËVE, BEBE TË VDEKURA...

Doktorët thonë se numri i bebeve të vdekura në Klinikën e gjinekologjisë në Shkup po zmadhohet sepse spitali paraqet qendër rajonale ku vijnë të gjitha rastet kritike nga brendia e shtetit si dhe nga spitalet private. Sipas tyre, nëse vjen deri në komplikime, qofshin ato edhe minimale, atëherë menjëherë nënën e transferojnë në Klinikën për gjinekologji në Shkup në të cilën ka më shumë se 50 gjinekologë.

Për statistikën e tilla të zeza problemi mund të kërkohet edhe në atë se shumë spitale në qytetet tjera në Maqedoni janë të mbyllura dhe ka vite të tëra që ato nuk funksionojnë, disa për shkak të kushteve katastrofale të higjienës, disa për shkak të mungesës të gjinekologëve, pediatrie, anesteziologëve. Por, ato që kanë mbetur, punojnë me një ose dy gjinekologë në qytetet në të cilët ka prej 70,000 deri në 100,000 banorë.

Por, të shkojmë me rend. Në spitalet në qytetet tjerë ka 69 gjinekologë – specialistë dhe 120 gjinekologë, që do të thotë se afër 700,000 gra nga vendi janë lënë në duart e 189 gjinekologëve. Sipas të dhënave me të cilët disponojmë, në Spitalin në Strumicë ka gjashtë gjinekologë, ndërsa në Vallandovë, Gjevgjeli, Radovish dhe Negotinë nuk ka asnjë gjinekolog. Në spitalin në Shtip ka katër gjinekologë, por sipas nevojës detyrë bëjnë edhe gjinekologët e familjes. Gjithashtu, në qytetet si Dibra dhe Kërçova ka nga dy gjinekologë, në Ohër pesë, ndërsa në Strugë dhe në Manastir nga nëntë gjinekologë, ndërsa në Kavadarci është evidentuar vetëm një gjinekolog. Në Negotinë nuk ka spital ku gratë mund të lindin, ndërsa në Kratovë dhe në KrivaPallankë vendet për lindje janë të mbyllura.

Gjinekologët me të cilët biseduam thonë se problemi është sistematik, se ka mungesë alarmante të gjinekologëve dhe se në shekullin 21 është tmerruese të vdesin aq numër të madh të bebeve.

*- Numri i bebeve të vdekura në Gjinekologji është tmerrues. Sa janë të aftë doktorët, nuk e di. Si arsye mund të cekën edhe lindjet e parakohshme, si dhe infektimet intrahospitale. Duhet të mbahet llogari për atë se a ka vdekur foshnja gjatë lindjes, pas lindjes ose fryti ka qenë i vdekur para se të lindë. Për një gjë jam i sigurt, se në mungesë të gjinekologëve, të gjithë vijnë në Gjinekologjinë në Shkup – thotë doktori*  
**Goce Çakarovski**, gjinekolog.

Por, ai thotë se nuk kupton si në këtë ndërtesë të re, si ajo e Gjinekologjisë, mund të ketë kaq shumë infektive dhe komplikime. Sipas tij, nuk është e qartë edhe pse menaxhmenti ka nevojë t'i fshejë numrat e bebeve të vdekura, kur ato janë të dhëna publike.

*- Me atë se i fshejnë numrat vetëm krijojnë dyshime më të mëdha. Gjithkund në botë ndodhin edhe gabime të doktorëve dhe infektive intrahospitale, por sa më shpejtë që ballafaqohemi me numrat, aq më shpejtë do t'i zgjidhim problemet. Duhet të tregohen problemet, që të mund të zgjidhen. Është fakt se problemi është sistematik. Në situata të tilla nëpër botë reagojnë menjëherë, do të hapen debate, do të ketë dorëheqje. Vetëm te ne askush nga pushteti i shëndetësisë nuk interesohet për këtë gjë – shtoi Çakarovski.*

Numrat e tilla rregullisht fshehen nën qilim, ndërsa për strategjinë e gabuar me të cilën udhëhiqet tërë sistemi shëndetësor, nuk përgjigjet askush. Të gjitha gratë në periudhën riprodiktive janë në duart e 120 gjinekologëve të mbingarkuar me administratë të

madhe, të cilët janë në situatë shumë të vështirë dhe për atë gjendja rezulton me numra të zeza të tilla.

Suaza:

## **TODOROV HESHTË PËR SKANDALIN, NDËRSA PROMOVON PROJEKT PËR ZVOGËLIMIN E VDEKJEVE TË BEBEVE**

Në ndërkohë, deri sa në opinionin shpërtheu skandali në Klinikën për gjinekologji në Shkup, ministri për shëndetësi heshtë për temën, mirëpo doli në konferencë të shtypit në të cilën u lavdërua se ministria bashkëfinancon specializimin e 47 gjinekologëve. Sipas planit, doktorët do të paguajnë vetëm 10% nga çmimi i specializimit, ndërsa pas mbarimit, do të kanë kontratë të garantuar me Fondin. Todorov shtoi se në këtë mënyrë do të përforcohet kjo pjesë e mjekësisë në vend dhe do të kontribuojë për zvogëlimin e vdekjeve të bebeve.

## DËSHMIM I RI I NJË NËNE PËR BEBËN E VDEKUR NË SHKUP

Në Gjinekologji bebet trajtohen si kukulla

Tridhjetë e tre vjeçja nga Shkupi për “Fokus” dëshmoi për tmerrin që ka kaluar në Klinikën për gjinekologji në Shkup, në rastin e fundit pas shumë vdekjeve të fëmijëve të porsalindur. Bebja është infektuar me sepsë, ndërsa doktorët e kanë bindur nënën se pikat e kuqe në trupin kanë dalë për shkak të alergjisë nga pampersi. Thotë se do ta padisë klinikën, dhe nëse ka nevojë do të shkon të kërkojë drejtësi në Hagë!

**Shkruan: Irena MULAÇKA**

Ish-ministri për shëndetësi në Malin e Zi, **Miodrag Radunoviq**, para dy viteve dha dorëheqje për shkak të skandalit që ndodhi në spitalin në Bjelo Pole ku pesë bebe u infektuan me infektim intrahospital, ndërsa një prej tyre vdiq. Sipas tij, është duhur urgjentisht të detektohen gabimet dhe të dënohen të gjithë ato të cilët do të konstatohet gabim, duke filluar nga pastrueset e deri te ministri. Por, ai shtoi, se ai duhet të jep dorëheqje i parë sepse është në krye të shëndetësisë dhe për këto arsye së shpejti u largua nga pozita ministër për shëndetësi.

Për dallim nga aty, në Maqedoni edhe pas skandaleve të numërta që me vite e tronditin shëndetësinë publike, si skandali “Perde”, doktorë që kontrollojnë paciente, ndërsa nuk kanë kryer universitetin e mjekësisë, bebe dhe nëna të vdekura, numri i madh i të sëmurëve dhe të vdekurve nga kanceri, gabimet e doktorëve... njeriu i parë i shëndetësisë **Nikola Todorov** nuk ndjeu përgjegjësi morale deri më tani, dhe as nuk ka qëllim të jep dorëheqje. Shembullin e tij e ndjekin edhe drejtorët e institucioneve publike shëndetësore, të cilët jo vetëm se nuk japin dorëheqje, por strategjia e tyre kryesore është të kërcënohen me padi kundër gazetarëve që të bëjnë shtypje, të krijojnë frikë dhe të gjejnë mënyrë si ta ndalojnë publikimin e informatave në të ardhmen.

I tillë është rasti me Klinikën për gjinekologji për të cilën “Fokus” tre muaj më parë publikoi se për gjashtë muaj kanë vdekur afër 80 bebe të porsalindura, prej të cilëve 20 kanë vdekur brenda dy javëve. Në disa muajt në vazhdim vazhduan statistikat e zeza të bebeve të vdekura. Pasi që doli teksti i parë, vazhduan të lajmërohen doktorë të revoltuar dhe nëna që ju kanë vdekur fëmijët, duke treguar në detaje tmerrin që kanë kaluar në Klinikën për gjinekologji. Në disa tekstet e publikuara deri më tani, treguam fatet tragjike të shumë familjeve, dhe disa prej tyre planifikojnë të padisin klinikën, ndërsa një pjesë prej tyre do të padisin doktorët që kanë bërë lindjen. Por, të gjithë janë të pajtuar dhe thonë “Na e nxinë jetën”.

### **BEBJA ËSHTË INFEKTUAR ME SEPSË, NDËRSA DOKTORËT KANË THËNË SE ËSHTË REAGIM NË PAMPERSIN**

Në redaksionin e “Fokus” të hënë u drejtua 33 vjeçja **E.P.** nga Shkupi, duke mos mundur të pajtohet me faktin se para një kohë të shkurtër ka blerë veshje dhe e ka përgatitur dhomën e fëmijëve për beben e saj, e cila është duhur të quhet **Anja**, e cila ka vdekur vetëm disa ditë pas lindjes në Gjinekologji. Ajo me ne shpërndau dokumente

nga periudha e shtatzënisë nga një spital privat, e deri në lindjen e saj në Klinikën për gjinekologji. Nëna e pakënaqur, gjithashtu na tregoi edhe fotografi nga bebja, e cila vetëm disa ditë pas lindjes është infektuar në klinikën dhe ka pasur pika të kuqe në tërë trupin.

Nëna e revoltuar na tregoi tërë procesin që ka kaluar në Klinikën për gjinekologji, sjelljen e keqe të doktorëve dhe stafit medicinal dhe kushtet e tmerrshme të higjienës në spitalin. Sipas saj, ajo tërë shtatzëninë e ka udhëhequr në një nga spitalet private deri në periudhën kur është dhurë të lindë në javën e 31 të shtatzënisë. Atëherë ka shkuar në Klinikën dhe siç thotë ajo “atëherë filloi tmerrri dhe humbja e bijës time”. Ajo në klinikë ka shkuar më 5 shtator, ndërsa ka mbetur aty deri më 13 shtator, ditën kur ka lindur.

*-Gjatë tërë kësaj periudhe kam qenë katër centimetra e hapur dhe pranoja antibiotikë landacin dhe magnezium. Më 12 shtator në mbrëmje, në ora 19 dhe 30 fitova dhimbje të cilët zgjatën tërë natën, ndërsa lindja filloi më 13 shtator në ora 9 e 25 minuta në mëngjes. Çka është edhe më tmerruese, në lindjen time nuk ishte prezent pediatri, edhe pse është e detyrueshme prezenca e tij duke marr parasysh se linda disa javë më herët – tha 33 vjeçja E.P.*

Bebja lindet më e vogël dhe e vendojnë në inkubator, por pa oksigjen sepse nuk ka qenë e varur nga oksigjeni. Menjëherë i kanë dhënë antibiotikë, duke shpjeguar se është infektuar nga nëna. Por, ky është konstatimi i doktorëve të Gjinekologjisë, ndërsa dokumentet që i kemi e thonë të kundërtën. Në dokumentacionin në të cilin janë treguar gjetjet laboratorike të mikrobiologjisë, mund të vërehet se të gjitha briset nga ekzaminimet mikrobiologjike të cilët i ka bërë nëna vetëm disa javë para lindjes janë negative dhe nuk ka infeksione, që do të thotë se bebja nuk ka mundur të infektohet nga ajo.

*- Që të shpëtohen, më lehtë e kanë të më fajësojnë mua, dhe filluan të thonë se bebja është infektuar nga unë, që nuk është e saktë, dhe këtë mund ta shihni në dokumentet. Bebja u lind e shëndoshë, vetëm ishte më e vogël dhe për atë e venduan në inkubator – shtoi nëna e revoltuar.*

Sipas saj bebja e saj është infektuar deri sa ka qenë në inkubatorin në klinikë, dhe këtë e thonë edhe doktorët e klinikës, por edhe ato të cilët e shikuan fotografinë e bebes me pika të kuqe nëpër tërë trupin.

Për atë që ka ndodhur me beben dhe me ndryshimet që kanë ndodhur pas lindjes, prindërit i kanë informuar më 15 shtator, vetëm dy ditë pas lindjes. Atëherë u kanë treguar diçka tjetër:

*- Nuk është asgjë serioze, është vetëm reagim në pampersin. Mos kini frikë, jemi duke e lyer me tretje fiziologjike. Do t'i kalojë. Kështu më thonin dhe më gënjyen në klinikë – thotë 33 vjeçja E.P.*

Më 15 shtator kanë ardhur lajme më të keqe. Ajo dhe bashkëshorti kanë qenë të informuar se bebja ka pasur gjakderdhje nga stomaku, ndërsa ditën e njëjtë i kanë bërë eho në kokën dhe aty nuk ka pasur gjakderdhje. Dy ditë më vonë, më 18 shtator, nga klinika ju kanë thënë se gjendja e bebes është stabile, nuk është as më mirë as më keq.

*- Na bindnin mos të kemi frikë, qëllimi i tyre ka qenë të na japin bebe të shëndoshë, ndërsa edhe mos të brengosemi shumë, sepse në shtëpi kemi edhe një fëmijë. Kjo do*

*të thotë se çfarë edhe të ndodhë me beben, nuk duhet të na tremb – tha nëna e bebes së vdekur.*

Bebja ka vdekur më 19 shtator në ora 4 e 50 minuta, ndërsa prindërit i kanë informuar tre orë më vonë, në ora 7 e 46. Trupi i bebes së vdekur menjëherë është dërguar në obduksion në Institutin për patologji, ndërsa në varësi nga gjetjet e obduksionit, familja do të vendos çfarë të bëjë më tej.

*-Do të shkoj deri në fund, për shkak tyre më vdiq bebja. Do t'i padisë dhe nëse duhet do të shkoj deri në Hag – tha bashkëbiseduesja e shqetësuar.*

## **RRITET VDEKSHMËRIA, ORGANET PËRKATËSE HESHTIN**

Por, ky nuk është rasti i vetëm i fëmijës së porsalindur që ka vdekur në shtator në Klinikën për gjinekologji në Shkup. Para dy javëve në klinikën ka pasur edhe një rast të vdekjes të bebes pas lindjes natyrore. Bëhet fjalë për pacienten **C.N.** e cila ka mbetur shtatzëne me proces “in-vitro”, ndërsa sipas informatave ka lindur në mënyrë natyrore më 21 shtator në javën e 36 të shtatzënisë. Bebja është lindur me peshë 1,620 gram. Vetëm tre ditë më vonë, më 24 shtator ka vdekur bebja dhe trupi i saj është dërguar në obduksion në Institutin për patologji.

Sipas doktorëve me të cilët biseduam ende nuk dihen arsyet e sakta pse ka vdekur bebja, si ka qenë shtatzënia e nënës gjatë tërë periudhës, a ka pasur probleme tjerë shëndetësorë etj. Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet t'i japin gjetjet nga obduksioni, të cilët sipas praktikës së deritanishme do të jenë gati pas dy muajve.

“Fokus” deri më tani publikoi më shumë se dhjetë raste të tmerrshme të bebeve të vdekura në Gjinekologjinë në Shkup, ndërsa arsyet kryesore për vdekshmërinë e zmadhuar sipas doktorëve janë infektimet intrahospitale me të cilët bebet janë infektuar deri sa kanë qëndruar aty, pastaj lindjet e parakohshme, si dhe gabimet mjekësore. Gjithashtu, ekzistonin disa raste të nënave të cilët dy muaj kanë qëndruar në dhoma të izoluara shkak se kanë pasur infektive dhe janë operuar disa herë.

*-Kjo që ndodhë në klinikë është e tmerrshme. Kemi gjinekologë, por nuk kemi mjaftë anesteziologë dhe pediatre, që janë të domosdoshëm që puna të kryhet ashtu si duhet. Dhe, pastaj e pyesim veten pse kemi aq numër të madh të vdekjeve, pse vdesin nënat dhe bebet. Që është edhe më alarmante, askush nuk ndërmer asgjë. Sillemi sikur të punojmë me kukulla, e jo me fëmijë – thotë doktori, i cili punon në klinikën, por kërkoi që të mbesë anonim, i frikësuar mos të humbasë vendin e punës.*

Edhe pas të gjitha rasteve që i publikoi “Fokus” deri më tani, në lidhje me Gjinekologjinë, drejtoresha **Marija Haxhi-Lega** nuk i publikon numrat e bebeve të vdekura për vitin 2016. Ajo na dërgoi tabelë në të cilën mund të shihet numri i bebeve të vdekura vetëm për periudhën deri në vitin 2015. Sipas të dhënave statistikore, në klinikën vitin e kaluar kanë vdekur 99 bebe, ndërsa një vit më parë, në vitin 2014, kanë vdekur 140 bebe. Numrat janë të ngjashëm edhe për vitet tjerë. Në vitin 2013 numri i bebeve të vdekura ka qenë 137, ndërsa në vitin 2012 ai numër ka qenë 125 bebe.

“Fokus” edhe kësaj radhe provoi të kontaktojë drejtoreshën Haxhi-Lega, të cilës deri më tani ikemi dërguar disa porosi në telefonin celular, duke kërkuar të na shpjegojë për sa është zmadhuar numri i vdekjes të fëmijëve të porsalindura, pse nuk merren përmasa



që të zvogëlohen numrat tmerruese dhe pse i injoron pyetjet tona. Deri në mbylljen e këtij numri të javores tonë nuk morëm përgjigje.

Herën e fundit kur drejtoresha e Gjinekologjisë komunikoi me “Fokus” ishte para dy viteve, në maj të vitit 2014, kur kërkuam të dhëna për atë sa është rritur numri i vdekjes të bebeve të porsalindura. Atëherë ajo na tha se ende janë duke u përpunuar të dhënat dhe se në kohë do të na informojë. Prej atëherë, ajo nuk përgjigjet as në thirrjet tona, as në sms-mesazhet.

Gjithashtu, disa pyetje i dërguam edhe deri në Ministrinë e arsimit, mirëpo edhe ato ka disa muaj që heshtin. Ashtu vepruan edhe kësaj radhe. Sidoqoftë, është kohë që institucionet të zbulojnë arsyet për numrat alarmuese të bebeve të vdekura në Gjinekologjinë në Shkup. Sepse, bëhet fjalë për njerëz të gjallë, e jo për kukulla. Publiku duhet të di, e posaçërisht familjet që kanë humbur bebet e tyre.

## **Suazë**

### **“SGS” MË NUK E SIGURON KLINIKËN**

Më shumë se një muaj, Klinika për gjinekologji në Shkup ka mbetur pa sigurimin privat “SecurityServiceGroup” (SGS) i cili ishte e angazhuar të sigurojë objektin, deri më 1 shtator, sipas kontratës. Para një viti pasi që dolën në opinion informata për sulmet e shpeshta të doktorëve dhe stafit mjekësor, klinika vendosi të sigurojë objektin, dhe në dispozitë kishte sigurim 24 orësh.

Ende nuk dihet a do të ketë tender të ri për sigurim privat dhe kush do të sigurojë objektin në ndërkohë. Atë që e dimë, është se për mbrojtje të stafit në Gjinekologji janë të detyruar dy infermierë, prej të cilëve njëri qëndron para derës së hyrjes, ndërsa tjetri te sallat për operacione.

Sipas të dhënave të Byrosë për prokurime publike, Klinikën një vjet e ka siguruar firma “SGS”, e cila në opinion është e njohur si firmë e afërt me drejtorin e DSK-së, **SashoMijallkov**, ndërsa këtë e dëshmuar edhe “bombat” që i publikoi lideri i LSDM-së, **ZoranZaev**. Kontrata me “SGS” ka qenë e nënshkruar më 7 gusht, vitin e kaluar, me vlerë prej 76,747 euro, ndërsa kriteri kryesor për zgjidhje të kësaj firme ka qenë çmimi më i ulët, edhe pse kjo ka qenë oferta e vetme në atë tender.

Para një viti, partia e opozitës LSDM publikoi “bombë” në të cilën u pohonte se pas firmës së famshme “SGS” qëndron Mijallkov. Ato në konferencën për shtyp në Kavadarci publikuan më shumë audio – incizime për të cilët ato thonë se dëshmojnë se Mijallkov është pronari i agjencisë për sigurim, e cila sipas tyre ka fituar para të mëdha (milionë) nga Qeveria e **Nikola Gruevskit**.

Gjithashtu, u publikua edhe bisedë mes Mijallkov dhe **DejanMitreovski-Urko**, ish truproja e kryeministrit Gruevski i cili u tërhoq nga agjencia për sigurim “Lupus”, pasi që “SGS” filloi të punojë me fuqi të plotë.

Gjithashtu, para një viti, LSDM doli me të dhëna për dhjetëra miliona euro të cilët kanë shkuar në konton e “SGS”, nga fitimi i tenderëve për sigurim.

## **Suazë:**

### **TESTET “PAP” NË GJINEKOLOGJI NUK JANË TË SAKTË?**

Para disa ditëve, Shoqata e gjinekologëve doli me informatë se rezultatet nga PAP-testet e bëra në Klinikën për gjinekologji nuk janë të saktë, jepen pa nënshkrim dhe vullë

dhe testi i dytë i bërë në vend tjetër zakonisht jep rezultate të ndryshme. Këtë e thotë doktori **Dushko Filipovski**, kryetari i Shoqatës. Ai dyshon në saktësinë e rezultateve dhe për këto arsye ka reaguar dy herë te ministria përkatëse.

Pas disa orëve u lajmëruan edhe nga Gjinekologjia dhe akuzuan se kjo është shpifje e pabazë me qëllim që të prishet reputacioni i këtij institucioni.

## DOKTORESHA NGA GJINEKOLOGJIA I ËSHTË KËRCËNUAR NJË NËNËS

**Nëse publikohet në “Fokus”, do të jetë fund për beben!**

**Skandali në Klinikën për gjinekologji po përhapet. “Fokus” disponon me emra të dhjetë pacienteve të reja, të cilët në pesë muajt e fundit kanë kaluar rrugë të vështirë në klinikën, shkak i operacioneve të bëra në mënyrë joprofesionale dhe janë infektuar me infeksione intrahospitale. Që të përmirësohen gabimet në moment të fundit dhe t’u shpëtohet jeta pacienteve kanë intervenuar kirurgë nga Klinika digjестive në Shkup**

**Shkruan: Irena MULAÇKA**

Një javë më parë, Zyra Shtetërore e Statistikave doli me të dhëna tmerruese se 90 bebe kanë vdekur në tremujorin e tretë të vitit, dy herë më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur kishte 39 fëmijë të vdekur. Sipas të dhënave të tyre, bilanci i zi i bebeve të vdekura po rritet në mënyrë alarmante, deri më tani vetëm për nëntë muaj, kanë vdekur 206 bebe, që nuk është numri përfundimtar duke marr parasysh se viti ende nuk ka mbaruar dhe se nuk ka informata për tremujorin e fundit.

Me këto statistika, Maqedonia u gjet në vendin e parë për vdekshmëri të bebeve në Evropë. Shkalla e vdekjes të bebeve, menjëherë pas lindjes është 14,3 për qind, që është tre herë më shumë se shkalla e Evropës, e cila është 5,2 për qind.

Para pesë muajve “Fokus” e hapi temën, dhe i publikuam të dhënat se në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, në Klinikën për gjinekologji në Shkup kanë vdekur më shumë se 80 foshnje të porsalindura. Edhe më tmerruese ishte situata kur brenda dy javëve humbën jetën 20 bebe. Edhe pse klinika është qendër kryesore në shtetin tonë, ku mbarojnë të gjitha rastet e komplikuara, që pjesërisht është arsyeja për numrin kaq të madh, prap skandalet vazhdojnë të tronditin dhe nga aty nuk ndalojnë të dalin informata për të dhënat tmerruese për raste të reja për bebe dhe nëna të vdekura, për diagnoza të gabuara dhe për operacione të bëra në mënyrë joprofesionale.

## **KIRURGËT ABDOMENAL I PËRMIRËSOJNË GABIMET E GJINEKOLOGJISË**

Në Klinikë çdo ditë vijnë edhe paciente që kanë kancer në mitrën, kancer në vezorët, ciste... të cilëve duhet t’u bëhen operacione urgjente. Nga aty vazhdimisht lavdërohen me punën e tyre personale, me stafin profesional dhe me higjienën e jashtëzakontë, por informatat që na erdhën e demantojnë pikturën “ideale” dhe prap alarmojnë për ngjarjet e tmerrshme në spitalin për shkak të mosprofesionalizmit të një pjesë të stafit, për shkak të higjienës të keqe dhe baktereve që gjinden aty.

Ende më tmerruese është se ministri për shëndetësi **Nikola Todorov**, me muaj të tërë heshtë në lidhje me këtë temë, i injoron pyetjet tona dhe kuptohet, e vazhdon fushatën parazgjedhore. Sepse, për pacientët bëhet fjalë!

Më shumë se dy muaj, në kolegjiunet profesionale në Klinikën për gjinekologji, në të cilën marrin pjesë mbi 70 gjinekologë, pediatre dhe anesteziologë nuk tregohen të dhënat për atë që ka ndodhur mbrëmjen e kaluar, sa bebe janë në gjendje kritike, a ka vdekur ndonjë bebe, sa raste të komplikuara ka tek pacientët, që ishte traditë me vite të

tëra në klinikën. “Fokus” disponon me emra të dhjetë pacienteve të reja, të cilët në pesë muajt e fundit kanë kaluar rrugë të vështirë në klinikën shkaku i operacioneve të bëra në mënyrë joprofesionale dhe janë infektuar me infeksione intrahospitale. Që të përmirësohen gabime në moment të fundit dhe t’u shpëtohet jeta pacienteve kanë intervenuar kirurgë nga Klinika digjестive në Shkup. Gjithashtu, redaksioni jonë i di emrat e doktorëve që i kanë bërë intervenimet, por vendosëm identitetin e tyre mos ta zbulojmë. Sipas burimeve tona, një nga pacientet që ka kaluar ferrin e Klinikës për gjinekologji është 49 vjeçja **T.S.** me numër të historisë 9189, të cilës më 29 qershor të këtij viti është duhur t’i bëhet histerektomilaparoskopike (nxjerrja e mitrës). Burimet tona thonë se gjatë intervenimit i është shpuar zorra e trashë, dhe është duhur të intervenojë kirurgu abdominal, i cili është thirrur nga vendi i punës që të përmirësojë gabimin që ka bërë doktori i gjinekologjisë gjatë operacionit.

Ajo nuk është e vetmja e cila është ballafaquar me probleme të tilla. E dyta në listë është pacientja 28 vjeçare **A.E.**, e cila më 4 korrik, këtë vit, ka lindur me seksion cezarian. Sipas historisë mjekësore me numër 9213, revizion i pacientes është bërë më 26 gusht, dhe prap është duhur të intervenojë një kirurg abdominal, ndërsa ajo më shumë se një muaj e gjysmë ka qenë e vendosur në klinikë.

Përveç te këtyre dy pacienteve, që t’i korrigjojnë gabimet mjekësore të kolegëve të tyre, kirurgët abdominal nga Klinika digjестive kanë intervenuar edhe te 73 vjeçja **V.P.** me numër të historisë 11462, e cila ka qenë e operuar nga kanceri i mitrës. Sipas të dhënave tona, 10 ditë më vonë asaj i është hapur plaga dhe i është intervenuar edhe dy herë. Por në vend të mbarojnë problemet e saj, përkundër atëherë kanë filluar. Në periudhën deri sa ka qëndruar aty, ajo është infektuar me infeksion intrahospital, për çka dëshmojnë edhe briset pozitive. Gruaja ka pasur plagë të infektuar dhe më shumë se një muaj është vendosur në dhomë të posaçme të izoluar.

Pacientja, e cila gjithashtu është e hospitalizuar në klinikën është edhe 64 vjeçja **J.P.** e cila është operuar nga tumori i vezorëve dhe shkaku i intervenimit të bërë në mënyrë jo të mirë i është dëmtuar zorra e trashë, dhe në këtë rast si në rastet tjerë ka intervenuar edhe kirurguabdominal. Sipas historisë të saj me numër 10787, gjatë rikuperimit në klinikë, është infektuar me infeksion intrahospital dhe ajo është vendosur në dhomë të posaçme të izoluar. Përveç tyre në klinikë ka edhe dy paciente që pas operacioneve janë infektuar, dëshmi për këtë janë edhe briset pozitive. Bëhet fjalë për 45-vjeçaren **J.S.** me numër të historisë mjekësore 13430 dhe për 58-vjeçaren **B.Z.** numri i të cilës është 10036. Të dyja kanë qenë të vendosura në dhoma të izoluar me qëllim mos të infektojnë edhe pacientët tjerë në departamentin e njëjtë.

Por, këtu nuk mbarojnë problemet në Klinikën për gjinekologji. Në fillim të muajit, më 1 nëntor ka qenë e hospitalizuar 39 vjeçja **M.N.**, e cila sipas burimeve tona ka pasur tumor në vezorët. Gjendja e saj shëndetësore ka filluar të keqësohet dhe ajo ditën e dytë është transferuar në kujdes intensive. Edhe pse është duhur të operohet pas dy ditëve, më 3 nëntor pacientja ka vdekur.

Në listën me intervenime të bëra në mënyrë joprofesionale mund të vendohet edhe pacientja **M.S.**, e cila sipas historisë mjekësore me numër 8747, ka qenë e operuar më 25 qershor, dhe më pas kanë ndodhur komplikime, dhe vetëm dy javë më vonë, më 4 gusht, i është bërë revizion nga kirurguabdominal.

Karakteristike për këto operacione është ajo se shumicën prej tyre i ka bërë doktor-specialist, emri i të cilit me vite të tëra është i njohur në opinion, por “Fokus” vendosi

mos ta zbulojë identitetin e tij. Ai është i njohur si një nga doktorët me të cilin në dhjetë vitet e fundit janë lidhur shumë skandale, edhe atë prej intervenimeve kirurgjike të kryera në mënyrë joprofesionale e deri në udhëtimet e bëra në llogari të klinikës.

“Fokus” kontaktoi me disa kirurgë nga Klinike digjestive në Shkup që të na shpjegojnë për çka zakonisht i thërrasin në intervenime në Klinikën për gjinekologji. Sipas tyre, më së shpeshti bëhet fjalë për diagnostikim të gabuar, për lëndim të zorrës së trashë, teknikë e gabuar gjatë punës, vlerësim i keq... Sipas kontratave, për intervenimet e tilla Klinika e gjinekologjisë duhet t’u paguajë kirurgëve, dhe në këtë mënyrë, për tre muaj Gjinekologjia ka bërë borxh ndaj kirurgjisë abdominale afër 280,000 denarë, prej të cilëve 33 për qind shkojnë për klinikën, ndërsa 67 për qind për doktorët që i bëjnë intervenimet.

“Fokus” dërgoi edhe disa pyetje në postën elektronike të klinikës që të na përgjigjen sa kirurgë abdominal kanë intervenuar tek pacientët e Klinikës së gjinekologjisë dhe sa para i kanë borxh Kirurgjisë abdominale? Por, deri në mbylljen e këtij numri të javores nuk na dhanë përgjigje.

## KËRCËNIM SKANDALUZ NGA DOKTORESHA

Para dy javëve në redaksionin e “Fokus” u lajmërua një grua 31 vjeçare, **Violeta Mitrevska** nga Shkupi, e cila në detaje na shpjegoi dramën që e ka përjetuar në Klinikën për gjinekologji, ku më shumë se një muaj në inkubator ka qenë bebja e saj e porsalindur.

Sipas fjalëve të saj, ajo në muajin e shtatë të shtatzënisë ka pasur shtypje të lartë, e cila i ka hipur edhe deri “190 me 100”, që ka mundur të jetë e rrezikshme edhe për atë edhe për jetën e bebes së saj. Mitrevska shtoi se në klinikë nuk kanë dashur ta pranojnë, edhe pse ka pasur goditje hipertensive, që ka mundur të shkaktojë lindje të parakohshme, dhe në fund ajo edhe ndodhi.

Nga momenti kur ka filluar t’i keqësohet gjendja, ajo më 13 tetor në ora 9 të mëngjesit ka hyrë në sallën për operacione, ku është duhur t’i bëhet seksion cezarian, por për arsye se në atë moment nuk ka pasur inkubator të lirë për beben, lindja është shtyrë për disa orë.

*-Nuk mund të ju shpjegojë se sa jam frikësuar. Më bindnin se beben duhet ta mbajë edhe 10 ditë. Gjendja e ime u keqësonte, ndërsa ato reagonin sikur të bëhet fjalë për ndonjë kukull, sikur të është gjë normale. Kur hyra të më lindin, së pari nuk kishte inkubator, ndërsa më vonë kur gjetën inkubator nuk kishte sallë të lirë. Kjo zgjati deri në ora 13.30, kur më në fund më operuan. Unë dhe vogëlushi im mezi shpëtuam – tha Mitrevska.*

Sipas dokumenteve me të cilët disponojmë, ajo në javën e 31 të shtatzënisë ka lindur djalë, me peshë 1,520 gram dhe i gjatë 39 centimetra, i cili sipas protokolleve të klinikës është duhur të mbesë në inkubator deri sa të rritë peshën. Këtu fillojnë edhe problemet e tyre. Në dokumentet shkruan se nëna është pranuar në klinikë më 8 tetor, ndërsa tre ditë më vonë ka lindur, më 16 tetor është lëshuar në shtëpi, ndërsa bebja ka ngelur në spital edhe një muaj.

*-Unë si nënë nuk kisha mundësi të shoh beben time. Më lejonin të hyj vetëm një herë në javë kur duheshe t’i jap qumësht bebes. Gjendja e tij disa herë u keqësua, e zvogëloi peshën, kishte edhe infeksion, ndërsa unë nuk dija çfarë po ndodh me të. Në telefon*

*nuk më jepnin informata, ndërsa sigurimi i SGS-së nuk më lejonte të vij as deri te hyrja. Më largonin me bërtitje dhe shkelma nga klinika. Duke qenë bebe e shëndoshë për pak do ta vdisnin aty... E tmerrshme. Sikur të gjendemi në Tanzani, e jo në Maqedoni – tha nëna 31 vjeçare.*

Si ka kaluar koha, e revoltuar nga sjellja e doktorëve dhe nga stafi medicinal në klinikën, nëna në një rast, njëerës prej tyre i ka thënë nëse vazhdojnë me sjelljen e keqe, do t'i zbulojë të gjitha informatat në "Fokus". Atëherë është habitur nga përgjigja e doktoreshës.

*-Nëse publikoni diçka në "Fokus", do të jetë fundi për beben! Me këto fjalë mu drejtua doktoresha, e cila ka bërë betimin e Hipokratit. Për ato më e rëndësishme është mos të del asgjë në gazetat, as pak nuk e kanë me rëndësi gjendjen e bebeve – konstatoi Mitrevska.*

Tërë kohën deri sa ishte në klinikë, redaksioni jonë ishte në kontakt me familjen, por ato nuk guxonin asgjë të nxjerrin në opinion, duke u frikësuar nga kërcënimet e doktoreshës. Sipas listës, bebja është në shtëpi nga 15 nëntori dhe atëherë prindërit e tij vendosën të shpërndajnë me publikun traumat që i kanë përjetuar në klinikën. Ato shtuan se pasi që është lëshuar nga spitali, bebja ka ardhur me verdhëz, e uritur, dhe nuk ka pasur refleksin e gëlltitjes.

## **NUMRAT E BEBEVE TË VDEKURA "SEKRET SHITETËROR"**

Pas shumë pyetjeve të dërguara deri te drejtorja e Klinikës për gjinekologji, **Marija Haxhi-Lega**, për numrin e vdekjeve të bebeve, për infeksionet intrahospitale, për pacientet e vdekura nga sepsa, pyetje për të cilët me muaj nuk mund të marrim përgjigje, më në fund u takuam drejtpërdrejtë me drejtoreshën në konferencën për shtyp më 17 nëntor, për Ditën botërore të fëmijëve të lindura parakohe. Në pyetjen tonë pse nuk ka pasur pediatër gjatë lindjes së një bebeve të lindur parakohe, e cila më vonë vdiq, Haxhi-Lega tha se sipas protokolleve ajo është e detyrueshme dhe se të gjithë prindërit që kanë ankesa mund të paraqiten te ajo.

*-Secila vërejtje mund të paraqitet dhe menjëherë të intervenohet – theksoi Haxhi-Lega.*

Por, pasi që e pyetëm sa bebe kanë vdekur në klinikën në disa muajt e fundit, ajo vetëm shkurt u përgjigj se statistika e saktë do të dihet në fund të vitit.

*-Në aspekt të numrit nuk duam të spekulojmë. Rezultatet zakonisht i mbledhim në fund të vitit, por mund të them se me kalimin e viteve numri i shkallës së mortalitetit në klinikën tonë është duke u zvogëluar. Por, është fakt se shkalla më e lartë e mortalitetit do të jetë në klinikën tonë, por është gjë normale duke marr parasysh se të gjithë rastet kritike i sjellin tek nesh. Vdekshmëria më e madhe ndodhë në rastet kur nënat lindin para javës së 28 të shtatzënisë – theksoi d-r Haxhi-Lega.*

Ajo nuk dinte pse prindërit të cilët mendojnë se bebet e tyre janë infektuar me sepsë nuk kanë reaguar, duke u arsyetuar se ato do të hetojnë se çfarë ka ndodhur.

Me drejtoreshën e klinikës arritëm të bisedojmë edhe për marrëdhëniet e prishura mes të punësuarve, për gabimet e doktorëve, diagnozat e gabuara, mosprofesionalizmi i një pjesë të stafit, por ajo i demantoi këto ngjarje, duke theksuar se gjithçka është duke funksionuar në mënyrë profesionale.

Disa muaj nuk kemi reagime për këtë temë as nga ministria e shëndetësisë dhe as nga ministri Nikola Todorov. Ai para pesë viteve kur u ul në karrigen ministrore, në disa

raste reagoi kur për shkak të gabimit mjekësor vdisnin nëna, dhe ngrinte padi kundër kryerësit të panjohur.

Por, ministri për shëndetësi tani heshtë më shumë se pesë muaj, edhe pse numri i bebeve të vdekura është duke u rritur. Todorov deri më tani nuk ndjeu nevojë të kontrollojë se çfarë ndodhë në Klinikën e gjinekologjisë, pse vdesin aq shumë bebe, pse prindërit vazhdimisht ankohen për trajtimin e keq dhe mosprofesionalizmin e një pjesë të doktorëve? Menaxhmenti në Gjinekologji mund të thotë se aty është gjithçka në rregull, por gjendja reale thotë diçka krejtësisht tjetër. Revolti dhe problemet e prindërve çdo ditë dalin në sipërfaqe, duke kërkuar zgjidhje në mediat dhe duke konsideruar se e drejta do të del në sipërfaqe. Sidoqoftë, përveç se është duke udhëhequr fushatë parazgjedhore, fotografohet dhe lutet për vota, ministri duhet të kthehet dhe të shoh se duhet t'u ndihmojë pikërisht atyre që i lut!

Suazë:

## **NË VEND SE NË UROLOGJI, KA MBARUAR NË GJINEKOLOGJI**

Se ndodhin gabime në Klinikën e gjinekologjisë në Shkup tregon edhe rasti me gruan 71 vjeçare **M.B.** me numër të historisë 13124, e cila në vend se të shkojë në operacion në Urologji, ajo ka mbaruar në Gjinekologji. Sipas historisë së spitalit, pacientja është duhur të bën operacion për tumor, por në moment të fundit kanë realizuar se është dërguar në vend të gabuar për intervencion. Pasi që ka ardhur urologu, menjëherë është transferuar në Klinikën për urologji.

Suazë:

## **DETYRIMET NË GJINEKOLOGJI PAGUHEN MË PAK**

Doktorët nga Klinika për gjinekologji kanë dërguar letër deri te Bordi menaxhues, në të cilën informojnë se detyrimet e tyre janë më pak të paguar edhe atë 1,300 deri në 1,400 denarë, për dallim nga klinikat tjera ku detyrimet paguhen mes 3,000 dhe 4,000 denarë. Ato kërkojnë të paguhen si të gjithë të tjerët, duke marr parasysh punën e madhe që e bëjnë.

## SKANDALI NË GJINEKOLOGJINË NË SHKUP PO ZGJEROHET

### Tre paciente të infektuara me infeksione spitalore

Dy muaj pasi që dolën informatat në “Fokus” se për gjashtë muaj në Klinikën për gjinekologji kanë vdekur 80 bebe, prej të cilëve 20 vetëm në dy javët e fundit, u paraqitën raste të reja të vdekjeve, kësaj radhe të pacienteve. Njërës prej tyre ia kanë nxjerrë mitrën sepse ka pasur ciste të thjeshtë, dhe kjo ka shkaktuar keqësim të gjendjes të saj, dhe më 17 gusht ka vdekur. Në Klinikë ka edhe tre paciente tjera të cilët janë të hospitalizuar afër dy-tre muaj, sepse gjatë operacionit janë infektuar me infeksione intrahospitale. Janë duke i mbajtur në dhoma të izoluar që mos t’i infektojnë pacientet dhe bebet tjera!

### Shkruan: Irena MULAÇKA

Para më shumë se një muaj “Fokus” publikoi tekste për skandalin në Klinikën për gjinekologji, ku për gjashtë muaj kanë vdekur më shumë se 80 bebe, prej të cilëve 20 kanë vdekur për dy javë. Mes arsyeve kryesore për numrin e vdekjeve të fëmijëve të porsalindura për të cilët shkruam, u theksuan paaftësia e doktorëve, mungesa e stafit, infeksionet intrahospitale, higjiena e dobët, si dhe fakti se të gjitha rastet e komplikuara nga spitalet tjerë në vend i dërgojnë menjëherë në këtë klinikë.

Menjëherë pas publikimit të aferës, reagan nga Klinika për gjinekologji dhe më në fund i nxorën numrat e bebeve të vdekura, por vetëm deri në vitin 2015, duke thënë se të dhënat që i kemi publikuar nuk janë të sakta. Por, në tekstet që i publikoi “Fokus” temë kryesore ishte vdekja e bebeve në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, për të cilët nga Klinika nuk treguan asnjë informacion.

Nga Klinika menjëherë u kërcënuan me padi, mirëpo me kërcënimet nuk iu drejtuan redaksionit tonë, por sipas informatave tona, të punësuarve, të cilët sipas menaxhmentit kanë nxjerrë dokumente nga klinika, dhe kërcënimet kanë nënkuptuar dëbim nga puna.

Dy muaj kaluan prej atëherë, por nga Gjinekologjia ende nuk morëm informata për numrin e vdekjeve të fëmijëve të porsalindur në vitin 2016, por sipas informatave tona numri është zmadhuar në periudhë të fundit dhe gjendja është alarmante. Por, këto nuk janë rastet e vetme të vdekjes në klinikën, e cila për vete thotë se është “institucion i njohur me traditë 70 vjeçare, me staf profesional”, sepse përveç bebeve në Gjinekologji vdesin edhe paciente.

Për ato arsye, vendosëm sërish t’i publikojmë të dhënat dhe informatat e fundit me lexuesit tonë. Ndërsa, u nisëm edhe pas përgjigjeve të pyetjeve tona – sepse institucionet përkatëse dhe ministri për shëndetësi **Nikola Todorov**, i cili më herët ka ngritur padi penale kundër kryerësit të panjohur, nuk reagojnë në lidhje me lëndën që të kontrollojnë se çka me të vërtetë është duke ndodhur në Klinikën për gjinekologji? Pse në mediat pro-qeveritare vazhdimisht sillen fushata për fëmijë të tretë? Çfarë të bëjnë nënat në raste kur kanë humbur beben, dhe nuk kanë kujt t’i drejtohen? Sa vlen jeta e njeriut në Maqedoni?



## PËR CISTË TË THJESHTË, JA KANË NXJERRË MITRËN DHE PACIENTJA KA VDEKUR

Sipas informatave të “Fokus” në disa javët e fundit, në Klinikën për gjinekologji në Shkup ka edhe disa raste të reja të bebeve të vdekura, por ka edhe nëna që kanë vdekur për shkak të gjakderdhjes të madhe shkaku i operacioneve të kryera në mënyrë të padrejtë.

Është e njohur se në Klinikë çdo ditë mbahet Kolegjiumi profesional në të cilin marrin pjesë më shumë se 70 gjinekologë, anesteziologë dhe pediatre, të cilët rregullisht tregojnë se çfarë ka ndodhur mbrëmjen e kaluar gjatë detyrave, sa bebe janë lindur, si është gjendja e bebeve dhe nënave, ose sa prej tyre janë në gjendje kritike.

Burimet tona thonë se në periudhën e fundit, pasi që dolën të dhënat në opinion, tradita e tillë është ndaluar, dhe në kolegjiumet nuk tregohet më a ka raste të reja të vdekjes të bebeve. “Fokus” disponon me dokumente të reja në të cilët shpjegohet tërë procesi që ka kaluar pacientja **E.T.**, e cila më 17 gusht, të vitit 2016, ka vdekur në Klinikën e gjinekologjisë. Sipas dokumenteve, ndërsa edhe sipas tregimeve të doktorëve, pacientja ka qenë e sëmurë nga leuçemia kronike mieloide e cila është shëruar me ilaçin glivek, por në klinikë ka ardhur për arsye tjetër, për operacion të thjeshtë të cistës. Para se të operohet, është formuar konsiliumi profesional nga tre doktorë, një gjinekolog dhe dy radiologë që të vlerësojnë gjendjen e saj të shëndetit.

Sipas informatave tona, konsiliumi i parë profesional aspak nuk ka vërejtur se pacientja ka leuçemi. Në dokumentet thuhet se më 9 gusht pacientes i është bërë operacion dhe i është nxjerrë mitra, edhe pse nuk ka pasur nevojë për një gjë të tillë. Ajo vazhdimisht ka pasur gjakderdhje. A kanë bërë gabim doktorët nga konsiliumi me vlerësimin se pacientja duhet të operohet, dhe me atë gjendja i është keqësuar?

Në ndërkohë, deri në momentin e vdekjes, janë mbajtur edhe dy konsiliume të formuar prej tre profesorëve, të cilët kanë alarmuar se pacientja duhet urgjentisht të operohet edhe një herë, sepse jeta e saj është në pyetje. Konsiliumi i fundit është mbajtur më 15 gusht, të vitit 2016 në ora 14.

*- Duke marr parasysh keqësimin e gjendjes së pacientes deri në momentin e mbajtjes të këtij konsiliumi, abdomeni i fryrë, nga KT në abdomen dhe pelvis të vogël - shenjat për ileus dhe nivelet hidrareike, konsiliumi vendosi urgjentisht të bëhet revizion në prani të kirurgut abdominal. Duke marr parasysh gjendjen e keqe nga sëmundja, është thirrur familja e pacientes, iu është shpjeguar për rreziqet nga operacioni dhe ato janë pajtuar të bëhet operacioni në interes të pacientes – thuhet në mendimin profesional nga tre doktorët. Pacientja për herë të dytë është operuar më 16 gusht, ndërsa ditën e ardhshme ka vdekur. Një pjesë e doktorëve në klinikë thonë se kirurgu që e ka operuar, e ka bërë punën e tij në mënyrë joprofesionale dhe nuk i ka respektuar protokollat. Redaksioni jonë i di emrat e doktorëve që kanë qenë në konsiliumin profesional, si dhe të kirurgut që e ka operuar pacienten, por vendosëm mos ta tregojmë identitetin e tyre.*

Vetëm disa ditë më vonë, më 25 gusht, në Klinikë ka pasur edhe një rast vdekje, ka vdekur grua e cila ka lindur. Sipas burimeve tona, bëhet fjalë për paciente 23 vjeçare nga Manastiri, e cila është pranuar në javën e 33 të shtatzënisë. Pacientja ka lindur me seksion cezarian, por ajo ka pasur edhe probleme shëndetësore paraprake. Dy muaj më herët ia kanë amputuar këmbën. Gruaja ka vdekur, mirëpo foshnja është gjallë dhe

për momentin gjendët në Klinikën për gjinekologji. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për gabim të doktorëve, por kur është pranuar pacientja ajo ka qenë në gjendje të keqe shëndetësore.

## **PACIENTE NË DHOMA TË IZOLUARA SHKAKU I INFEKSIONEVE**

Pas teksteve të publikuara në “Fokus” për skandalin në Klinikën për gjinekologji në Shkup, prej aty së shpejti dërguan demant në të cilin u lavdëruan për punën e tyre profesionale, stafit profesional dhe higjienës të jashtëzakonshme në klinikën. Por, informatat e reja të cilët na erdhën, e demantojnë pikturën “ideale” dhe sërish alarmojnë për ngjarjet e tmerrshme në klinikën, shkaku i mosprofesionalizmit të stafit, si dhe higjienës të dobët.

Dëshmi për atë janë tre paciente, të cilët më shumë se dy muaj qëndrojnë në klinikën për shkak të infektiveve intrahospitale, me të cilët janë infektuar gjatë shërimit në këtë spital. Të trijat janë të vendosura në tre dhoma të izoluara dhe nuk kanë kontakt me pacientët tjerë, me nënat dhe me bebet, që mos t'i infektojnë. Redaksioni jonë disponon me emrat dhe mbiemrat e pacienteve dhe me historitë e tyre mjekësore. Njëra prej tyre është **S.M.**, 36 vjeçare, nga Kavadarci, me numër të historisë 8747, e cila dy muaj është duke u shëruar në Klinikë. Ajo ka qenë e sëmurë nga adenokarcinom (kanceri i mitrës), dhe më 25 korrik, këtë vit, i është bërë operacion, histerektomi radikale (nxjerrja e mitrës). Por, në vend se të mbarojnë problemet e saj, përkundër ato sapo kanë filluar. Në periudhën deri sa ka qëndruar në klinikën është infektuar me infeksion intrahospital, gjë për të cilën kanë dëshmuar briset pozitive. Gruaja ka pasur plagë të infektuar, dhe është duhur të operohet prap, ndërsa intervenimi është bërë më 4 gusht. Pas 25 ditëve, pacientja të martën është lëshuar në shtëpi.

Ajo nuk është pacientja e vetme e cila është ballafaquar me një problem të tillë. Pacientja e dytë, e cila ende është e hospitalizuar në klinikën, është 28 vjeçja **E.A.** nga Vinica, e cila gjithashtu, deri më tani është operuar dy herë. Sipas historisë së saj mjekësore me numër 9213, patientes më 4 korrik, të vitit 2015 i është bërë seksion cezarian, por në ndërkohë ajo është infektuar me infeksion intrahospital, shkaku i të cilit është duhur t'i bëhet edhe një operacion. Pas dy muajve të kaluara në klinikë për shkak të infektimit të plagës, patientes 28 vjeçare i është bërë revizion të plagës së infektuar të premtën, më 26 gusht, edhe atë në prani të kirurgut plastik.

Por, këtu nuk mbarojnë problemet në Klinikën për gjinekologji. Pacientja e tretë, e cila ka qenë e operuar tre herë brenda dy muajve, është 70 vjeçja **Z.H.** nga Shkupi, të cilës më 22 qershor i është nxjerrë mitra. Prej atëherë fillojnë problemet e saj shëndetësorë. Në ndërkohë, derisa ka qenë e hospitalizuar në klinikë, është infektuar, dhe i është hapur plaga dhe prap kanë bërë operacion më 18 korrik, këtë vit. Një muaj më vonë, patientes prap i bëhet operacion, më 29 gusht, kështu që ajo më shumë se dy muaj është e vendosur në klinikë.

“Fokus” prap provoi të kontaktojë drejtoreshën e Klinikës për gjinekologji, d-r **Marija Haxhi-Lega** që të na përgjigjet në disa pyetje dhe të jep mendimin e saj në lidhje me situatën, por ajo vazhdimisht është duke na injoruar. Sipas praktikës të deritanishme, vetëm një ditë pas daljes së numrit të ri të gazetës, ajo menjëherë shkruan demant, në të cilin prap nuk ipet përgjigje në asnjë pyetje të parashtruar, nuk i demanton rastet e publikuara, por e lavdëron klinikën dhe stafin profesional që punon aty dhe kërcënohet me padi.

Ministri për Shëndetësi, Todorov, gjithashtu një kohë të gjatë i injoron pyetjet e “Fokus” në këtë temë, edhe pse në disa raste e pyetëm dhe insistuam të na tregojë çfarë do të bën në lidhje me vdekshmërinë e zmadhuar të bebeve në klinikën shtetërore, duke marr parasysh se vazhdimisht lavdërohet se numri i vdekjeve të fëmijëve të porsalindur është zvogëluar dhe se Maqedonia ka një ndër sistemet më të mira të shëndetësisë në Evropë.

## **HAXHI-LEGA ËSHTË KRYESORJA NË GJINEKOLOGJI**

Klinikën për Gjinekologji afër katër vite e udhëheq d-r Marija Haxhi-Lega, e cila në këtë funksion ka ardhur në vitin 2012, vetëm disa muaj pasi që e lindi gruan e ministrit për shëndetësi, Todorov, me fëmijën e dytë. Ajo gjatë tërë periudhës punon si drejtoreshë e përkohshme, edhe pse sipas ligjit, ashtu guxon të punojë vetëm 6 muaj. Gjinekologjia është klinika e vetme, e cila disa vite nuk ka drejtor ekonomik, i cili do të drejtohet me paratë, edhe pse sipas ligjit, të gjithë klinikat janë të detyruara të drejtohen nga dy drejtorë nëpërmjet të nënshkrimit të lidhur, një drejtor shëndetësorë dhe një ekonomik. Klinika, për herë të fundit ka pasur drejtor ekonomik në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2012, kur në atë pozitë ka qenë **Elisej Cicimov**, i cili tani punon në Zyrën e punësimit.

A mund të vijë deri në ndryshim të pozitës të drejtorit në Gjinekologji është pyetje e cila parashtrohet gjatë javës së fundit, pasi që, dy javë më parë, në një nga gazetatat ditore është paraqitur konkurs për dy drejtorë të klinikave në Shkup, ndër të cilëve është klinika e gjinekologjisë. Konkursi ka zgjatur shtatë ditë, deri të hënën. A do ta mbajë Haxhi-Lega këtë funksion ose do të jetë e ndërruar do të tregojë koha, duke marr parasysh se disa kolegë të saj kanë konkurruar për atë vend.

Gjatë “sundimit” të saj, klinikën e ndoqën shumë skandale, ndër të cilët ishte edhe pajisja e kabinetit të saj me mobile nga firma italiane “Kaza Italia”, që kushtoi afër 20,000 euro. Tërë kabineti i saj është në ngjyrë të gjelbër me mobile të bardha. Të gjithë këto të dhëna janë publike dhe ishin të publikuara në ueb faqen e Byrosë për prokurime publike.

Përveç se Klinika për gjinekologji gjendet në ndërtesë të re dhe disponon me pajisje të re, ajo është një ndër klinikat që ka buxhet më të lartë, i cili në vitin 2015 ka qenë 6,5 milion euro, ndërsa në vitin 2016 është zmadhuar dhe tani është afër shtatë milion euro. Sa edhe të dëshirojnë institucionet përkatëse të tregojnë pikturën e bukur për shëndetësinë publike, prap informatat tmerruese dalin në sipërfaqe. Në arkivat e Gjinekologjisë mbesin historitë mjekësore për atë se sa paciente dhe bebe kanë vdekur gjatë viteve, edhe pse problem paraqet edhe ajo se të gjithë rastet kritike nga qytetet dhe spitalet tjerë mbarojnë aty. Klinika ka drejtoreshë, e cila mund t’i tregojë publikisht problemet, në vend se të luftojë me mediat. Tek e fundit, bëhet fjalë për jetën e njerëzve, vlera e të cilëve në Maqedoni ka prekur fundin!

Suaza:

**GJATË VËRSHIMEVE, EDHE PODRUMI I GJINEKOLOGJISË NËN UJË**

Vërshimet që e kapluan Shkupin më 6 gusht i ka mbushur me ujë edhe podrumet e Klinikës për gjinekologji, ndërsa aty bëhen analizat e gjakut të pacientëve. Sipas informatave tona, edhe në ato kushte, kur gjithçka ka qenë nën ujë, stafi ka vazhduar aty t'i bëjë analizat deri në momentin kur ka ardhur inspeksioni dhe iu ka ndaluar të vazhdojnë. Atëherë kanë filluar të gjinden dhe në moment të fundit kanë filluar të bëjnë analizat në klinikat tjera.